

PLANIFIKIMI VJETOR

- **PLANI MESIMOR – KLASA 9**
- **FUSHA: ARTE**
- **LENDA: ART PAMOR**

Hyrje

Fusha e arteve është pjesë e rëndësishme e kurrikulës, në të cilën përfshihen aspekte të kulturës materiale, shpirtërore, artistike, intelektuale dhe emocionale, ku ndërveprojnë kultura dhe shoqëria. Mësimi i arteve u ofron nxënësve mundësi për të zhvilluar njohuritë artistike përmes mjeteve shprehëse si: tingujve, ngjyrave, formave, fjalës, lëvizjeve. Ato mësohen, formohen dhe kultivohen përmes teknikave e proceseve artistike, nxitin të mësuarit konkret të artit, gjatë procesit mësimor në shkollë dhe në jetën e përditshme.

Kompetencat përmbajtësore që zhvillon fusha e arteve në të gjitha shkallët, kontribuojnë në arritjen e kompetencave kyç, në funksion të të nxënësve gjatë gjithë jetës.

Arti pamor në klasën e 9-të kërkon nga nxënësit të krijojnë dhe të realizojnë punët e tyre në mënyrë më sistematike, të vlerësojnë artet duke krijuar gjykime dhe qëndrime të qarta nëpërmjet njohjes dhe gjykimit të zhvillimit të tyre historik, duke krijuar kompetenca të qëndrueshme dhe të zbatueshme në këto disiplina artistike. Artet janë konceptuar në funksion të të nxënësve gjatë gjithë jetës. Aspektet e të nxënësve në fushën e arteve do të zhvillojnë mundësitë e nxënësve për të njohur gjuhën artistike të arteve, për të realizuar dhe për të prezantuar punë të ndryshme artistike, për të vlerësuar veprat e arteve të ndryshme. Artet stimulojnë ndërgjegjësimin trupor, ushqejnë imagjinatën dhe kontribuojnë në zhvillimin e vetëbesimit. Fusha e arteve ndihmon në krijimin e identitetit dhe në pasurimin e botëkuptimit të nxënësve, mundëson zhvillimin e vetëdijes dhe identitetit kombëtar, nëpërmjet trajtimit të elementeve dhe vlerave artistike kulturore të trashëgimisë sonë kombëtare.

Edukimi nëpërmjet “Artit pamor” siguron zhvillimin e krijimtarisë dhe përvojave personale nëpërmjet zbulimit, kërkimit, eksperimentimit, trillimit, vizatimit dhe përdorimit të një sërë mjeteve dhe teknikave. Kjo lëndë promovon vëzhgimin dhe ndihmon nxënësit/set të fitojnë ndjeshmëri për botën vizuale, hapësinore dhe të prekshme, dhe për eksperiencat estetike.

Në artin pamor imazhi mund të marrë forma të ndryshme, në varësi të mjeteve dhe materialeve që përdoren për ta realizuar atë. Ky imazh mund të jetë *dy ose tredimensional, abstrakt ose figurativ, dinamik ose statik*, etj. Gjithashtu, ai krijohet duke përdorur teknika të

ndryshme artistike, ku përzgjedhja e materialeve dhe organizimi i gjuhës vizuale në një vepër varen nga mesazhi që ajo do të komunikojë. Edukimi, nëpërmjet lëndës së artit pamor, nxit zhvillimin e përgjithshëm të nxënësit dhe pasuron kulturën e tij/saj, duke ndihmuar nxënësit të deshifrojnë mesazhet pamore, të vëzhgojnë imazhet me një ndjeshmëri më të lartë, të ushtrojnë mendimin kritik dhe ndjenjën estetike. Sot në kulturën edukative i kushtohet shumë rëndësi pranisë së imazhit, dhe në këtë drejtim artet pamore luajnë një rol themelor në zhvillimin social, ekonomik dhe artistik të nxënësve. Ky program bën të mundur konsolidimin e mëtejshëm të njohurive të artit pamor. Edhe në këtë shkallë ky program bazohet në tre kompetenca, krijimi artistik, realizimi i punimit dhe vlerësimi i veprave të artit. Krijimtaria në art, kontribuon në rritjen e vetëbesimit dhe ndihmon në krijimin vetëdijes kulturore dhe ndjeshmërisë artistike, ku nxënësit/set kanë mundësi të krijojnë imazhet e tyre, duke u përfshirë në procesin krijues, duke zbuluar mundësi të shumta të kombinimit të materialeve me gjuhën vizuale, për të komunikuar mendimin e tyre për një audiencë të caktuar. Nëpërmjet lëndës së artit pamor, nxënësit/set inkurajohen të bëjnë lidhjen e artit pamor me lëndët e tjera në kurrikul dhe ta shohin artin si një mundësi karriere. Në këtë mënyrë ata hapin një dritare me botën për të zbuluar karakteristikat e veçanta të saj dhe të kuptojnë më mirë kulturën e tyre. Në këtë mënyrë nxënësit/set zhvillojnë identitetin e tyre kulturor dhe përgatiten për rolin e tyre si qytetar.

Rezultatet kryesore të të nxënit sipas kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së artit pamor, shkalla e katërt.

SHKALLA E KATËRT
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
<ul style="list-style-type: none">• Zhvillon personalitetin e vet dhe është aktiv në veprimtaritë artistike;• Gjykon drejt mesazhet, që u adresohet;• Shprehet qartë dhe saktë me anë të simboleve, shenjave dhe gjuhës vizuale;• Komunikon qartë mendimin e tij/saj;• Shfrytëzon në mënyrë të vazhdueshme, të pavarur, kritike dhe krijuese, mjetet artistike dhe mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit në art pamor në mënyrë të pavarur, të vazhdueshme.
Kompetenca e të menduarit
<ul style="list-style-type: none">• Përpunon njohuritë vizuale në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi;• Zgjidh në mënyrë të pavarur probleme të ndryshme artistike;• Zhvillon aftësitë për të menduar dhe argumentuar në mënyrë kritike, krijuese dhe ndërvepruese;• Ndjek me vëmendje udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari artistike.
Kompetenca e të mësuarit për të nxënë
<ul style="list-style-type: none">• Përzgjedh në mënyrë të pavarur mjetet për të realizuar një krijim artistik;• Përdor burime të ndryshme për të realizuar një krijim;• Zgjidh në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë.
Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin
<ul style="list-style-type: none">• Drejton dhe merr pjesë aktive në aktivitete të artit pamor si brenda dhe jashtë klasës, duke kontribuar në mënyrë krijuese;• Kupton dhe gjen zgjidhje në mënyrë të pavarur për problemet ekologjike, duke u ndërgjegjësuar për rolin e tyre në mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm.
Kompetenca personale

- Krijon besimin tek vetja gjatë veprimtarive artistike;
- Merr pjesë në mënyrë aktive në jetën artistike shkollë dhe komunitet;
- Ndërgjegjëson veten dhe zhvillon vetëbesimin dhe krijimin e besimit te të tjerët.

Kompetenca qytetare

- Diskuton dhe bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore;
- Respekton punën e vet dhe të të tjerëve;
- Bashkëpunon me të tjerët, pavarësisht kulturës, aftësive dhe nevojave brenda dhe jashtë shkollës për një qëllim të përbashkët.

Kompetenca digjitale

- Gjen, prodhon, krijon, prezanton dhe shkëmben informacion si dhe bashkëpunon në rrjetet e informuese në internet;
- Përdor mjetet të ndryshme në funksion të informacionit artistik si: video CD, DVD, aparat fotografik digjital, kamera, etj.

Koha mësimore për secilën tematikë, klasa 9-të

Lënda e artit pamor zhvillohet për 35 javë mësimore me nga 1 orë secila, pra gjithsej 35 orë për secilën klasë. Programi i lëndës së artit pamor specifikon peshën (orët e sugjeruara) e secilës tematikë për secilën shkallë dhe klasë. Shuma e orëve sugjeruese për secilën tematikë është e barabartë me sasinë e orëve vjetore, të përcaktuar në planin mësimor të arsimit bazë. Kjo ka si qëllim që përdoruesit e programit të orientohen për peshën që zë secila tematikë në orët totale vjetore.

	Gjuha dhe komunikimi artistik	Teknikat dhe proceset	Historia, arti dhe shoqëria	Gjithsej orë
Klasa e nëntë	10	15	10	35

PLANIFIKIMI 3 – MUJOR

Tematikat	Shpërndarja e përmbajtjes lëndore për realizimin e kompetencave		
	Shtator- Dhjetor (10 orë)	Janar – Mars (15 orë)	Prill – Qershor (10 orë)
<p>Tematika 1:</p> <p>Gjuha dhe komunikimi artistik</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Vija. 2. Vija në skulpturë dhe arkitekturë. 3. Forma dydimensionale Format pozitive dhe negative. 4. Ngjyrat monokromatike 5. Tekstura si mjet shprehës në dizajn 6. Vëllimi dhe mënyrat e paraqitjes në pikturë dhe në vizatim 7. Vëllimi dhe mënyrat e paraqitjes në pikturë dhe në vizatim 8. Perspektiva me tri pika 		

	<p>ikje</p> <p>9. Ekuilibri ose peshë pamore</p> <p>10. Figura e njeriut</p>		
<p>Tematika 2:</p> <p>Teknika dhe procese artistike</p>		<ol style="list-style-type: none"> 1. Teknikat grafike: lapustilat dhe përdorime të ndryshme 2. Teknikat grafike: Eksperimente 3. Grafiti urban 4. Teknika stampimi dekorative, Xilografia 5. Teknika stampimi dekorative, Monotipi 6. Fotokolazhi 7. Ushtrime 8. Tekstil dizajni 9. Fashion Dizajni 10. Skulptura, modelimi me materiale të ndryshme 11. Gdhendja mbi materiale të buta 	

		<p>12. Derdhja forma pozitive dhe forma negative</p> <p>13. Maket skene në miniatyre me materiale të ndryshme dhe të riciklueshme</p> <p>14. Ndërtimi i kutisë skenike</p> <p>15. Prekjet përfundimtare</p>	
<p>Tematika 3: Historia, arti dhe shoqëria</p>			<ol style="list-style-type: none"> 1. Zhvillimi i artit, pasimpresionizmi 2. Avangardat artistike Fovizmi,ekspresioniz mi 3. Kubizmi, Futurizmi 4. Dada, Surrealizëm 5. Abstraksionizmi 6. Arti në gjysmën e dytë të shekullit XX, ekspresionizmi abstrakt, pop art, skulptura në gjysmën e dytë të shek. XX, arkitektura në gjysmën e dytë të shek. XX 7. Arti në Shqipëri, “arti i realizmit socialist”

			<p>8. Trashëgimi kulturore, Qytetet muze dhe arkitektura e tyre tradicionale</p> <p>9. Ekspozita dhe ngjarje kulturore. Ekspozita, projekte artistike në klasë, shkollë dhe komunitet</p> <p>10. Media. Libra, revista, postera, filma, aparat fotografik, kompjuter etj</p>
--	--	--	--

PLANIFIKIMI 3- MUJOR SHTATOR- DHJETOR (10 ORË)

TEMATI KA (ORË)	TEMAT MËSIMORE	SITUATË E PARASHIKUA R E TË NXËNIT	METODOLO GJIA DHE VEPRIMTAR IA E NXËNËSVE	VLERËSIMI	BURIMET
Gjuha dhe komuniki mi artistik 10 orë	1. Vija	Nxënësit/et vëzhgojnë mjedisin përreth ose në vepra arti dhe identifikojne lloje të ndryshme vijash. Evidentojnë funksionin dhe vlerat e vijave. Nxënësit shprehen nëpërmjet vijave.	Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim	Vlerësohet nxënësi në të gjitha fazat e orës së mësimit, për aktivizimin, diskutimin në grup ose individual dhe punën e pavarur.	Teksti Materiale ilustruese Modele përkatëse
	2. Vija në skulpturë dhe arkitekt urë.	Nxënësit/et vëzhgojnë veprat skulpturore dhe arkitekturore dhe identifikojne lloje të ndryshme vijash. Evidentojnë funksionin dhe vlerat e vijave. Nxënësit shprehen nëpërmjet vijave.	Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim	Vlerësohet nxënësi në të gjitha fazat e orës së mësimit, për aktivizimin, diskutimin në grup ose individual dhe punën e pavarur.	Teksti Materiale ilustruese Modele përkatëse
	3. Forma dydimensional e Format pozitive dhe	Nxënësit/et japin shembuj nga natyra të formave gjeometrike. Krahasojnë format gjeometrike me ato natyrore dhe	Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim	Vlerësohet nxënësi në të gjitha fazat e orës së mësimit, për aktivizimin, diskutimin në grup ose individual dhe punën e pavarur.	Teksti Materiale ilustruese Modele përkatëse

	negativ e.	artificiale. Bëjnë dallimin mes formave dy dhe tripërmasore duke e konkretizuar këtë edhe me gjinitë e artit. Vlerëson përdorimin e formave pozitive dhe negative (mardhenia figure sfond) në art nga artistë të ndryshëm.	Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim	Vlerësohet nxënësi në të gjitha fazat e orës së mësimit, për aktivizimin, diskutimin në grup ose individual dhe punën e pavarur.	
	4. Ngjyrat monokromatike	Nxënësit rikujtojnë rrethin e ngjyrave, ngjyrat parësore, dytësore, të ftohta, të ngrohta. Kuptojnë dhe realizojnë diferencën tonale brenda të njëjtes ngjyre (duke erresuar me të zeze ose duke çelur me të bardhe). Kuptojnë dhe realizojnë intesitetin e ngjyres duke i perzier me ngjyren gri për të krijuar variacione. Gjithashtu ilustrojnë shembuj të cilësive të ngjyrave nga mjedisi rrethues. Nxënësit krijojnë me teknikën që	Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim	Vlerësohet nxënësi në të gjitha fazat e orës së mësimit, për aktivizimin, diskutimin në grup ose individual dhe punën e pavarur. Vlerësohet nxënësi në të	Teksti Materiale ilustruese Modele përkatëse

		duan sipas ushtrimeve në libër.		gjitha fazat e orës së mësimin, për aktivizimin, diskutimin në grup ose individual dhe punën e pavarur.	
5. Tekstura si mjet shprehës në dizajn	Nxënësit zbulojnë diferencën midis tekstures fizike dhe tekstures vizuale. Ata dallojnë teksturen fizike në natyrë si psh, i lëmuar, e ashpër, e fortë etj. Zbulojnë karakteristikat e sipërfaqeve dhe teksturave vizuale të ndryshme të krijuara nga njeriu (psh. vizatimi i nyjeve të drurit në leter është teksture vizuale) Vëzhgojnë mënyrën se si artistët kanë krijuar teksturën në veprat e tyre, në pikturë dhe dizajn.	Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim		Vlerësohet nxënësi në të gjitha fazat e orës së mësimin, për aktivizimin, diskutimin në grup ose individual dhe punën e pavarur.	Teksti Materiale ilustruese Modele përkatëse
6. Vëllimi dhe mënyrat e paraqitjes në pikturë dhe në vizatim	Nxënësit/et zbulojnë se forma dhe vëllimi i objekteve bëhet i dukshëm për syrin tonë nëpërmjet burimit të dritës. Nxënësit/et zbulojnë që vëllimi i objekteve realizohet përmes vlerës tonale. Nxënësit/et ushtrohen me laps në krijimin e një shkalle tonale me të pakten 7 tone	Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim		Vlerësohet nxënësi në të gjitha fazat e orës së mësimin, për aktivizimin, diskutimin në grup ose individual dhe punën e pavarur.	Teksti Materiale ilustruese Modele përkatëse

		nga e bardha e letres deri te e zeze maksimale dhe me pas e perdorin kete shkalle per te interpretuar objekte te thjeshta gjeometrike (sfere, kubë, cilindër, molle veze etj).	analizë, vlerësim, interpretim		
	7. Vëllimi dhe mënyrat e paraqitjes në pikturë dhe në vizatim	Nxenesit/et ushtrohen me ngjyra (teknike e lire)ne krijimin e nje shkalle tonale me ngjyra (kujtojme vleren tonale tek ngjyrat monokromatike), te pakten 10 tone. Nxenesit/et me pas e perdorin kete shkalle per te interpretuar objekte te thjeshta apo fruta te ndryshme.	Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim	Vlerësohet nxënësi në të gjitha fazat e orës së mësimin, për aktivizimin, diskutimin në grup ose individual dhe punën e pavarur.	Teksti Materiale ilustruese Modele përkatëse
	8. Perspektiva me tri pikë	Nxënësit/et diskutojne mbi njohurite e meparshme qe kane per prespektiven me një pikë, perspektivën me dy pika. Ata ushtrohen per te kuptuar ndertimin e	Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim	Vlerësohet nxënësi në të gjitha fazat e orës së mësimin, për aktivizimin, diskutimin në grup ose individual dhe punën e pavarur.	Teksti Materiale ilustruese Modele përkatëse

		figures se kubit permes pikave te ikjes ne raport me vijen e horizontit. Nxënësi përdor figurën e tekstit sipas udhëzimeve per te krijuar prespektiven me tre pika ikje.			
	9. Hapsira Ekuilibri ose pesha pamore	Nxënësit/et pyeten çfare kuptojne me ekuilibër. Nxenesit diskutojne rreth ekuilibrit ne fizikë dhe ekuilibrit pamor. Nxenesit/et analizojne menytrat e arritjes se ekuilibrit pamor permes ekuilibrit simetrik, asimetrik, dhe ekuilibrit radial. Ata ushtrohen ne menyren sesi ndikojne elementete artit ne peshen pamore, (psh figurat e medha jane me te renda se figurat e vogla, ngjyrat e ndezura jane me te renda se ngjyrat e zbehta etj..)			Teksti Materiale ilustruese Modele përkatëse
	10. Hapsira	Nxënësit/et krijojne figurën e			Teksti Materiale

	figura e njeriut	njeriut sipas udhëzimeve ne tekst.			ilustruese Modele përkatëse
--	------------------	------------------------------------	--	--	--------------------------------

PLANIFIKIMI 3- MUJOR JANAR- MARS

TEMATI KA (ORË)	TEMAT MËSIMOR E	SITUATË E PARASHIKUAR E TË NXËNIT	METODO LOGJIA DHE VEPRIMTARIA E NXËNËSV E	VLERESI MI	BURIMET
Teknika dhe procese artistike 15 orë	1. Teknikat grafike: lapustilat dhe përdorimet e të ndryshme	Nxënësit prezantohen me teknikën e lapustilave. Zbulojnë efektet dhe mundësitë shprehëse dhe i përdorin në një krijim. Diskutojnë në klasë për të përbashkëtat dhe të veçantat e e kesaj teknike krahasuar me teknika te tjera. Analizon dhe vlerëson piktura në teknikën e lapustilave. Nxënësit punojnë të	Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim,	Vlerësohet nxënësi në të gjitha fazat e orës së mësimit, për aktivizimin, diskutimin në grup ose individual dhe punën e pavarur. Vlerësohet nxënësi në të gjitha fazat e orës së mësimit, për aktivizimin, diskutimin	Teksti Materiale ilustruese Modele përkatëse

		pavarur .	punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim	në grup ose individual dhe punën e pavarur.	
	2. Teknikat grafike: lapus tilat dhe përdorime të ndryshme eksperimente	Nxënësit prezantohen me teknikën e lapustilave. Zbulojnë efektet dhe mundësitë shprehëse dhe i përdorin në një krijim. Diskutojnë në klasë për të përbashkëtat dhe të veçantat e e kesaj teknike krahasuar me teknika të tjera. Analizon dhe vlerëson piktura në teknikën e lapustilave. Nxënësit punojnë të pavarur .	Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim	Vlerësohet nxënësi në të gjitha fazat e orës së mësim, për aktivizimin, diskutimin në grup ose individual dhe punën e pavarur.	Teksti Materiale ilustruese Modele përkatëse
	3. Grafiti urban	Nxënësi identifikon veprat dhe karakteristikat e teknikës së grafitit urban të artistëve të ndryshëm. Nxënësi diskuton kushtet sociale që ndikuan veprat e artit. Nxënësi/et ushtrohen në	Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim	Vlerësohet nxënësi në të gjitha fazat e orës së mësim, për aktivizimin, diskutimin në grup ose individual dhe punën e pavarur.	Teksti Materiale ilustruese Modele përkatëse

		krijimin e nje grafiti ne tekniken e lapustilave.		fazat e orës së mësim, për aktivizimin, diskutimin në grup ose individual dhe punën e pavarur.	
	4. Teknika stampimi dekorative, Xilografia	Nxënësit japin shembuj në klasë dhe në mjedisin rrethues të posterave, librave, banerave etj, që kanë lidhje me stampimin. Njihet me teknikat e ndryshme të stampimit. Nxënësit diskutojnë për përdorimin e stampimit në art dhe në jetën e përditshme. Vlerësojnë rolin e stampimit në jetën e përditshme dhe në art si dhe ku gjen përdorim në cilat fusha të jetës.	Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim	Vlerësohet nxënësi në të gjitha fazat e orës së mësim, për aktivizimin, diskutimin në grup ose individual dhe punën e pavarur. Vlerësohet nxënësi në të gjitha fazat e orës së mësim, për aktivizimin, diskutimin në grup ose individual dhe punën e pavarur.	Teksti Materiale ilustruese Modele përkatëse
	5. Teknika stampimi dekorative	Nxënësit ushtrohen ne tekniken e monotipit	Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim,	Vlerësohet	Teksti Materiale ilustruese Modele përkatëse

	rativ e, Mon otipi		interpretim	nxënësi në të gjitha fazat e orës së mësimit, për aktivizimin, diskutimin në grup ose individual dhe punën e pavarur.	
6.	Foto kolazhi	Nxënësi/et identifikon veprat dhe karakteristikat e teknikës së Fotokolazhit të artistëve të ndryshëm. Nxënësi diskuton kushtet sociale që ndikuan veprat e artit. Nxënësi/et identifikojne artistet që kanë punuar në këto teknike dhe analizojne veprat e tyre. Nxënësi/et ushtrohen në krijimin e një fotokolazhi sipas ushtrimit në liber.	Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim		Teksti Materiale ilustruese Modele përkatëse
7.	Foto kolazhi	Nxënësi/et identifikon veprat dhe karakteristikat e teknikës së Fotokolazhit të artistëve të ndryshëm. Nxënësi diskuton kushtet sociale që	Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim Marrëdhënia pyetje-përgjigje,		Teksti Materiale ilustruese Modele përkatëse

		ndikuan veprat e artit. Nxenesi/et identifikojne artistet qe kane punuar ne kete teknike dhe analizojne veprat e tyre. Nxenesi/et ushtrohen ne krijimin e nje fotokolazhi sipas ushtrimit ne liber.	diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim		
	8. Teksti dizajni	Nxenesi/et diskutojnë rreth punimeve te tekstit qe kane neper shtepite e tyre, për pamjen e tyre, funksionin që kanë. Krahasojnë si kanë evoluar objektet e përdorimit të përditshëm deri në ditët tona. Nxjerrin në pah veçoritë e tekstileve shqipëtare. Ata/ato nxiten të përdorin simetrinë për te krijuar nje model per qilim, bazuar	Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim		Teksti Materiale ilustruese Modele përkatëse

		ne forma gjeometrike.			
	9. Fashion dizajni	Nxënësi/et ushtrohen për të krijuar një bluze bazuar në një leter-model.		Vlerësohet nxënësi në të gjitha fazat e orës së mësimi, për aktivizimin, diskutimin në grup ose individual dhe punën e pavarur.	Teksti Materiale ilustruese Modele përkatëse
	10. Skulptura, modelimi materiale të ndryshme	Nxënësit diskutojnë për llojet e ndryshme në të cilat paraqitet skulptura. Japin argumente dhe opinionet e tyre për imazhet e paraqitura dhe gjejnë ndryshimet. Nxjerr në pah vlerat dekorative dhe artistike të skulpturës. Krahasojnë pikturën dhe skulpturën, gjejnë të veçantat dhe të përbashkëtat. Aplikon modelimin sipas tekstit.		Vlerësohet nxënësi në të gjitha fazat e orës së mësimi, për aktivizimin, diskutimin në grup ose individual dhe punën e pavarur.	Teksti Materiale ilustruese Modele përkatëse
	11. Gdhendja mbimaterialite buta	Nxënësi përdor materiale të ndryshme për të krijuar në skulpturë (skulpturë e rrumbullakët, relief); shpjegon		Vlerësohet nxënësi në të gjitha fazat e orës së mësimi, për aktivizimin, diskutimin në grup ose individual dhe punën e pavarur.	Teksti Materiale ilustruese Modele përkatëse

		marrëdhënien midis formës dypërmasore dhe asaj trepërmasore në skulpturë			
	12. Derd hja forma positive dhe forma negative	Nxënësi përdor materiale të ndryshme për të krijuar në skulpturë (skulpturë e rrumbullakët, relief); shpjegon marrëdhënien midis formës dypërmasore dhe asaj trepërmasore në skulpturë;			Teksti Materiale ilustruese Modele përkatëse
	13. Maket skene në miniaturre me materiale të ndryshme dhe të riciklueshme	Nxënësit japin shembuj të konstruksionit në art. Njihen me degët e konstruksionit dhe specifikat e tyre. Dallojnë karakteristikat e konstruksionit dhe japin shembuj nga jeta, arti, arkitektura. Njihen me profesionet që lidhen me konstruksionin dhe veçoritë e tyre. Gjejnë		Vlerësohet nxënësi në të gjitha fazat e orës së mësimin, për aktivizimin, diskutimin në grup ose individual dhe punën e pavarur.	Teksti Materiale ilustruese Modele përkatëse

		mesazhin në një scenografi të një teatri			
	14. Ndërtimi I kutisë skenike	Nxënësi projektton dhe realizon në miniaturë një skenë teatri ose spektakli;	Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim	Vlerësohet nxënësi në të gjitha fazat e orës së mësimit, për aktivizimin, diskutimin në grup ose individual dhe punën e pavarur.	Teksti Materiale ilustruese Modele përkatëse
	15. Prekjet Përfundimtare	Nxënësi projektton dhe realizon në miniaturë një skenë teatri ose spektakli;	Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim	Vlerësohet nxënësi në të gjitha fazat e orës së mësimit, për aktivizimin, diskutimin në grup ose individual dhe punën e pavarur.	Teksti Materiale ilustruese Modele përkatëse

PLANIFIKIM 3- MUJOR PRILL – QERSHOR

LËNDA: ART PAMOR 9

TEMATIK A (ORË)	TEMAT MËSIMORE	SITUATË E PARASHIKU AR E TË NXËNIT	METODOLO GJIA DHE VEPRIMTAR IA E NXËNËSVE	VLERESIM I	BURIMET
Historia, arti dhe shoqëria 10 orë	<p>1. Zhvillim i i artit, pasimprasionizmi</p>	<p>Nxënësit diskutojnë rreth periudhave më të rëndësishme nëpër të cilat ka kaluar njerëzimi, nga pikëpamja historike. Nxjerrin në pah veçoritë e artit pasimresionist. Nëpërmjet imazheve ata njihen me artistet kryesore të kesaj periudhe të artit dhe veçoritë e tyre. Krahasojnë veprat e artit të kesaj periudhe me periudha të tjera për të parë si ka evoluar arti. Kuptojnë rëndësinë e artit në zhvillimin e shoqërisë dhe si njerëzit u morën me art në periudha të</p>	<p>Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim</p> <p>Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë,</p>	<p>Vlerësohet nxënësi në të gjitha fazat e orës së mësimit, për aktivizimin, diskutimin në grup ose individual dhe punën e pavarur.</p> <p>Vlerësohet nxënësi në të gjitha fazat e orës së mësimit, për aktivizimin, diskutimin në grup ose individual dhe punën e</p>	<p>Teksti</p> <p>Materiale ilustruese</p> <p>Modele përkatëse</p>

		ndryshme.	vlerësim, interpretim	pavarur.	
	2. Avangar dat artistike fovizmi, ekspresi onizmi	Nxënësit diskutojnë rreth periudhave më të rëndësishme nëpër të cilat ka kaluar njerëzimi, nga pikëpamja historike. Nxjerrin në pah veçoritë e ketyre periudhave. Nëpërmjet imazheve ata njihen me artistet kryesore te ketyre periudhave te artit dhe veçoritë e tyre. Krahasojnë veprat e artit të këtyre periudhe me periudha te tjera për të parë si ka evoluar arti. Kuptojnë rëndësinë e artit në zhvillimin e shoqërisë dhe si njerëzit u morën me art në periudha të ndryshme.	Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim	Vlerësohet nxënësi në të gjitha fazat e orës së mësimin, për aktivizimin, diskutimin në grup ose individual dhe punën e pavarur.	Teksti Materiale ilustruese Modele përkatëse
	3. Kubizmi , Futuriz mi	Nxënësit diskutojnë rreth periudhave më të rëndësishme nëpër të cilat ka kaluar njerëzimi, nga pikëpamja historike.	Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari	Vlerësohet nxënësi në të gjitha fazat e orës së mësimin, për aktivizimin, diskutimin në grup ose individual dhe	Teksti Materiale ilustruese Modele përkatëse

		<p>Nxjerrin në pah veçoritë e ketyre periudhave. Nëpërmjet imazheve ata njihen me artistet kryesore te ketyre periudhave te artit dhe veçoritë e tyre. Krahasojnë veprat e artit të këtyre periudhe me periudha te tjera për të parë si ka evoluar arti. Kuptojnë rëndësinë e artit në zhvillimin e shoqërisë dhe si njerëzit u morën me art në periudha të ndryshme.</p>	<p>artistike, analizë, vlerësim, interpretim</p>	<p>punën e pavarur.</p>	
	4. Dada, surrealizëm	<p>Nxënësit diskutojnë rreth periudhave më të rëndësishme nëpër të cilat ka kaluar njerëzimi, nga pikëpamja historike. Nxjerrin në pah veçoritë e ketyre periudhave. Nëpërmjet imazheve ata njihen me artistet kryesore te ketyre periudhave te artit dhe veçoritë</p>	<p>Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim</p>	<p>Vlerësohet nxënësi në të gjitha fazat e orës së mësimit, për aktivizimin, diskutimin në grup ose individual dhe punën e pavarur.</p>	<p>Teksti</p> <p>Materiale ilustruese</p> <p>Modele përkatëse</p>
			<p>Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e</p>	<p>Vlerësohet nxënësi në të gjitha fazat e orës së mësimit, për aktivizimin,</p>	

		<p>e tyre. Krahasojnë veprat e artit të këtyre periudhe me periudha të tjera për të parë si ka evoluar arti. Kuptojnë rëndësinë e artit në zhvillimin e shoqërisë dhe si njerëzit u morën me art në periudha të ndryshme.</p>	<p>pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim</p>	<p>diskutimin në grup ose individual dhe punën e pavarur.</p>	
	<p>5. Abstraksionizmi</p>	<p>Nxënësit diskutojnë rreth periudhave më të rëndësishme nëpër të cilat ka kaluar njerëzimi, nga pikëpamja historike. Nxjerrin në pah veçoritë e abstraksionizmit. Nëpërmjet imazheve ata njihen me artistet kryesore të kesaj periudhe të artit dhe veçoritë e saj. Krahasojnë veprat e artit të kësaj periudhe me periudha të tjera për të parë si ka evoluar arti. Kuptojnë rëndësinë e artit</p>	<p>Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim</p>		<p>Teksti</p> <p>Materiale ilustruese</p> <p>Modele përkatëse</p>

		në zhvillimin e shoqërisë dhe si njerëzit u morën me art në periudha të ndryshme.			
	6. Arti në gjysmën e dytë të shekullit XX, ekspresionizmi abstrakt, pop art, skulptura në gjysmën e dytë të shek. XX, arkitektura në gjysmën e dytë të shek. XX	Nxënësit diskutojnë rreth periudhave më të rëndësishme nëpër të cilat ka kaluar njerëzimi, nga pikëpamja historike. Nxjerrin në pah veçoritë e këtyre periudhave. Nëpërmjet imazheve ata njihen me artistet kryesore të këtyre periudhave të artit dhe veçoritë e tyre. Krahasojnë veprat e artit të këtyre periudhave me periudha të tjera për të parë si ka evoluar arti. Kuptojnë rëndësinë e artit në zhvillimin e shoqërisë dhe si njerëzit u morën me art në periudha të ndryshme.			Teksti Materiale ilustruese Modele përkatëse
	7. Arti në Shqipëri, “arti i	Nxënësit diskutojnë rreth periudhave më të		Vlerësohet nxënësi në të gjitha fazat e orës së	Teksti Materiale

	realizmit socialist ”	<p>rëndësishme nëpër të cilat ka kaluar arti shqiptar, nga pikëpamja historike.</p> <p>Nxjerrin në pah veçorinë e kësaj periudhe.</p> <p>Nëpërmjet imazheve ata njihen me veprat e artit dhe veçoritë e tyre.</p> <p>Krahasojnë veprat e artit me njëra tjetrën për të parë si ka evoluar arti në vendin tonë nga periudha në periudhë.</p> <p>Kuptojnë rëndësinë e artit në zhvillimin e shoqërisë dhe rolin e artit në shoqërinë shqiptare.</p>		mësimin, për aktivizimin, diskutimin në grup ose individual dhe punën e pavarur.	<p>ilustruese</p> <p>Modele përkatëse</p>
	8. Trashëgimi kulturor e, Qytetet muze dhe arkitektura e tyre tradicionale	<p>Nxënësit/et diskutojnë për njohuritë që kanë mbi këto qytetërime antike duke iu referuar fotografive.</p> <p>Krahasojnë objektet arkeologjike të vendit tonë me</p>	Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim	Vlerësohet nxënësi në të gjitha fazat e orës së mësimin, për aktivizimin, diskutimin në grup ose individual dhe punën e pavarur.	<p>Teksti</p> <p>Materiale ilustruese</p> <p>Modele përkatëse</p>

		ato të qytetërimit grek dhe romak.			
	9. Ekspozita dhe ngjarje kulturor e. Ekspozita, projekte artistike ne klase, shkolle dhe komunitet	Nxënësi përzgjedh krijimet më të mira për t'i prezantuar në portofolin e nxënësit. Nxënësi merr pjesë në ekspozita e projekte artistike në klasë, shkolle e komunitet.	Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim	Vlerësohet nxënësi në të gjitha fazat e orës së mësimit, për aktivizimin, diskutimin në grup ose individual dhe punën e pavarur.	Teksti Materiale ilustruese Modele përkatëse
	10. Media. Libra, revista, poster, film, aparat fotografik, kompjuter etj	Nxënësit/et diskutojnë për rolin e medias në shoqëri. Nxjerrin në pah rolin e komunikimit si një nga proceset më të rëndësishme jetësore të njeriut. Nxënësit/et zbulojnë si ka evoluar komunikimi përmes mediave të ndryshme.	Marrëdhënia pyetje-përgjigje, diskutim, vëzhgim, punë e pavarur, krijimtari artistike, analizë, vlerësim, interpretim	Vlerësohet nxënësi në të gjitha fazat e orës së mësimit, për aktivizimin, diskutimin në grup ose individual dhe punën e pavarur.	Teksti Materiale ilustruese Modele përkatëse

Planifikimi i orës mësimore			
Fusha: Arte	Lënda: Art pamor	Shkalla: 4	Klasa: IX
Tematika: Gjuha dhe komunikimi artistik			
Tema mësimore: Vija			
Situata e te nxënit: Nxënësit/et vëzhgojnë mjedisin përreth ose në vepra arti dhe identifikojnë lloje të ndryshme vijash. Evidentojnë funksionin dhe vlerat e vijave. Nxënësit shprehen nëpërmjet vijave.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave:		Fjalë Kyç:	
<ul style="list-style-type: none"> • percepton lloje të ndryshme vijash në mjedisin rrethues • evidenton funksionet dhe vlerat e vijave • shprehet nëpërmjet vijës dhe përdor karakteristikat e saj • vlerëson rolin e vijave në historinë e artit dhe në fushat e tjera. 		vija vija tregon konturet vija tregon drejtimin vija tregon levizjen dhe planet	
Burimet: Art pamor 9		Lidhja me fushat e tjera:	
Metodologjia/ teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve:			
Hapi i parë: Parashikim me terma paraprakë			
Mësuesi/ja vendos imazhe në tabelë, ku evidentohen lloje të ndryshme vijash në natyrë dhe nxit nxënësit të flasin rreth tyre.			
Vizatort në tabelë lloje të ndryshme vijash. Mund edhe të ftojë një nxënës që t'i vizatojë. Ndërkohë nxit nxënësit të emërtojnë vijat e vizatuara dhe i shkruan në tabelë.			
Pyet nxënësit:			
-Çfarë mund të thoni për vijën?			
-Ku gjen përdorim ajo?			
-A mund të jepni shembuj nga mjedisi rrethues për vijat?			
-Nisur nga njohuritë që keni nga se krijohet një vijë?			
Në art është një gjurmë mbi një sipërfaqe, e përbërë nga bashkimi i shumë pikave.			
Vija si mjet shprehës.			
Mësuesi/ja fton nxënësit të diskutojnë për llojet e vijave të përdorura në një vizatim.			
-Çfarë lloje vijash ka përdorur autori?			
-A janë të gjitha në një drejtim?			
-Çfarë kuptoni ju nga këto lloj vijash?			
Mësuesi/ja shpjegon se artisti nëpërmjet përdorimit të llojeve të ndryshme të vijave na tregon forcën e tyre shprehëse, e cila varet nga drejtimi, trashësia, forca etj.			
-A do të ishte interesante nëse të gjitha vijat e përdorura nga artisti do			

të ishin në të njëjtin drejtim dhe të gjitha në të njëjtën trashësi?

Hapi i dytë: Diskutim / Analizë rasti

Mësuesi/ja fton nxënësit të diskutojnë rreth imazheve në libër. Pasi nxënësit japin mendimet e tyre mësuesi/ja pyet:

-Çfarë kanë të përbashkët këto imazhe?

-A ka ndryshim vija në secilin nga imazhet? Pse?

Mësuesi/ja përmbledh mendimet e nxënësve dhe shpjegon se vija është rezultat i dukshëm i një lëvizje dhe e demonstroi këtë në tabelë me një vijë të thjeshtë. Pyet nxënësit:

-Si mund të realizohet një vijë?

-Çfarë ndikon në realizimin e vijës?

Duke u nisur nga imazhet në libër mësuesi/ja shpjegon se vija është një element shumë i rëndësishëm i gjuhës pamore.

Pyet nxënësit:

-Si merr jetë ideja e një artisti? (Nga përdorimi i vijave).

Cili është hapi fillestar për krijimin e një vepre? (Skica).

Nxënësit japin komentet e tyre.

Ne skulpture dhe arkitekture linja përbën profilin e formës së tyre, përcakton drejtimin dhe lëvizjen (vertikalitetin apo mënyrën si ndyshojnë planet etj).

Hapi i tretë: Punë individuale

Mësuesi/ja fton nxënësit të krijojnë duke përdorur lloje të ndryshme vijash dhe me mjete të ndryshme.

Mund edhe të imitohen lloje të ndryshme vijash nga natyra, si lëvorja e pemës, rrjeta e merimangës etj.

Shembulli tregon si mund të krijohet me vija dhe nxënësit mund të shkruajnë karakteristika për veten ose për shokun/shoqen.

Nxënësit punojnë të pavarur.

Vlerësimi: Vlerësohet nxënësi në të gjitha fazat e orës së mësimi, për aktivizimin, diskutimin në grup ose individual dhe punën e pavarur.

Detyra: Nxënësit krijojnë sipas udhëzimeve në libër dhe diskutojnë në klasë.

Planifikimi i orës mësimore			
Fusha: Arte	Lënda: Art pamor	Shkalla: 4	Klasa: IX
Tematika: Gjuha dhe komunikimi artistik			
Tema mësimore: Forma dydimensionale Format pozitive dhe negative.			
Situata e te nxënit: Nxënësit/et japin shembuj nga natyra të formave gjeometrike. Krahasojnë format gjeometrike me ato natyrore dhe artificiale. Bëjnë dallimin mes formave dy dhe tripërmasore duke e konkretizuar këtë edhe me gjinitë e artit. Vlerëson përdorimin e formave pozitive dhe negative (mardhenia figure sfond) në art nga artistë të ndryshëm.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave:		Fjalë Kyç:	
<ul style="list-style-type: none"> • zbulon që format bazë gjeometrike gjenden edhe në natyrë; • kërkon në mjedisin • krijon me format gjeometrike dhe klasifikon llojet e formave. • nxjerr konkluzionin që disa forma janë të rregullta dhe disa të çrregullta, disa janë natyrale dhe disa artificiale • bën lidhjen e formave me gjinitë e artit • kupton rolin dhe rëndësinë e formave positive dhe negative në krijimtarinë artistike. 		forma forma natyrore forma gjeometrike marredhenia figure sfond	
Burimet: Art pamor 9		Lidhja me fushat e tjera:	
Metodologjia/ teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve:			
<p>Hapi i parë: Stuhi mendimi / Parashikim me terma paraprakë Mësuesi/ja vizaton lloje të ndryshme formash gjeometrike, forma tripërmasore. Nxiti nxënësit të flasin rreth tyre duke u bazuar në njohuritë që ata kanë. Pyet nxënësit: -Çfarë kuptoni ju me fjalën “ formë” ? -C ili është ndryshimi midis figurave gjeometrike dhe trupave gjeometrikë? -Po në art si i klasifikojmë këto forma? -A mund të gjeni në mjedisin përreth forma të ngjashme me format gjeometrike ose trupat gjeometrikë? Nxënësit japin komentet e tyre në lidhje me pyetjet e bëra.</p> <p>Hapi i dytë: Diskutim / Analizë rasti Mësuesi/ja fton nxënësit të vëzhgojnë imazhet e vendosura në tabelë. Nxiti nxënësit të krahasojnë imazhet me njëra-tjetrën dhe të gjejnë format sipas llojit. Nxënësit japin komentet e tyre. Forma përcakton pamjen e jashtme të një sipërfaqe të caktuar ose të një objekti nëpërmjet konturit. Format janë dy dhe trepërmasore. Format klasifikohen në natyrore dhe artificiale të krijuara nga njeriu.</p>			

Mësuesi/j fton nxënësit të japin shembuj të formave përkatëse.

Mësuesi/ja i referohet imazheve në libër dhe në tabelë dhe fton nxënësit të shohin përdorimin e formave positive dhe negative në art. Ato paraqiten si në motivet popullore, ashtu dhe në pikturat e artistëve me famë. Nxënësit diskutojnë rreth imazheve dhe gjejnë llojet e formave të përdorura në veprat e paraqitura.

Hapi i tretë: Punë individuale

Mësuesi/ja fton nxënësit të krijojnë në një fletë me kutia një motiv popullor.

Nxënësit mund të vizatojnë edhe kafshë duke u nisur nga ndërtimi me figurat gjeometrike. Mund të krijojnë një kompozim me ndërthurjen e formave positive dhe negative.

Nxënësit punojnë të pavarur.

Vlerësimi: Vlerësohet nxënësi në të gjitha fazat e orës së mësimt, për aktivizimin, diskutimin në grup

ose individual dhe punën e pavarur.

Detyra: Nxënësit krijojnë sipas udhëzimeve në libër dhe diskutojnë në klasë.

Planifikimi i orës mësimore			
Fusha: Arte	Lënda: Art pamor	Shkalla: 4	Klasa: IX
Tematika: Gjuha dhe komunikimi artistik			
Tema mësimore: Ngjyrat monokromatike			
Situata e te nxënët: Nxënësit rikujtojnë rrethin e ngjyrave, ngjyrat parësore, dytësore, të ftohta, të ngrohta. Kuptojne dhe realizojne diferencen tonale brenda te njejtës ngjyre (duke erresuar me te zeze ose duke çelur me te bardhe). Kuptojne dhe realizojne intesitetin e ngjyres duke i perzier me ngjyren gri per te krijuar variacione. Gjithashtu ilustronjë shembuj të cilësive të ngjyrave nga mjedisi rrethues. Nxënësit krijojnë me teknikën që duan sipas ushtrimeve në libër.			
Rezultatet e të nxënët sipas kompetencave:		Fjalë Kyç:	
<ul style="list-style-type: none"> • njihet me eksperimentin e prizmit sipas Njutonit • dallon me karakteristikat shprehëse të ngjyrave dhe klasifikimine tyre; • përcakton nëpërmjet krijimit të tij/saj rolin e spektrit tëngjyrave. • përkufizon cilësitë e ngjyrës dhe karakteristikat fizike të saj. • percepton ngjyrat si mjet artistik. • përdor ngjyrat si mjet artistik, si dhe kupton mundësitë shprehëse. • vlerëson rëndësinë e ngjyrës në artin pamor. 		ngjyra rrethi i ltenit ngjyra parësore ngjyra dytësore ngjyra tretësore ngjyra të ngrohta, të ftohta, ngjyra monokromatike tonalitet dhe intesiteti I ngjyres	
Burimet: Art pamor 9		Lidhja me fushat e tjera:	
Metodologjia/ teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve:			
<p>Hapi i parë: Parashikim me terma paraprakë Ç'është ngjyra? Mësuesi/ja pyet nxënësit: -Çfarë dini ju për ngjyrat? -Si janë të vendosura ato dhe si i klasifikojmë? Nxënësit japin komentet e tyre nisur dhe nga njohuritë e mëparshme. -Cili ka qenë ai që ka bërë të mundur rrethin e ngjyrave?</p> <p>Hapi i dytë: Diskutim / Analizë rasti Tonalitetet e ngjyrës Mësuesi/ja pyet nxënësit: -Shikoni rreth e rrotull a kemi veshje me të njëjtën ngjyrë? -Si mendoni pse ndryshojnë? -Sa lloje blush, jeshilesh, të kuqesh etj. kemi? Mësuesi/ja shpjegon se ngjyra ndryshon në varësi të së bardhës dhe të zezës që përmban. Prandaj këto veshje kanë një ngjyrë, por nuanca të ndryshme. Vlera tonale. E njëjta ngjyrë, e çelur me te bardhe ose e erresuar me te zeze. Ka një pafundësi tonalitetesh të së njëjtës ngjyrë. Mësuesi/ja fton nxënësit të diskutojnë për tabelën</p>			

e tonaliteteve dhe të shohin ndryshimet që pëson ngjyra në këtë tabelë.

Intesiteti i ngjyres. Ndryshon duke l shtuar gri ngjyres, duke e bere ate me pak vezulluese.

Hapi i tretë: Punë individuale

Mësuesi/ja fton nxënësit të eksperimentojne duke ndjekur ushtrimet ne liber.

Nxënësit punojnë të pavarur.

Vlerësimi: Vlerësohet nxënësi në të gjitha fazat e orës së mësimi, për aktivizimin, diskutimin në grup

ose individual dhe punën e pavarur.

Detyra: Nxënësit krijojnë sipas udhezimeve ne libër dhe diskutojnë në klasë.

Planifikimi i orës mësimore			
Fusha: Arte	Lënda: Art pamor	Shkalla: 4	Klasa: IX
Tematika: Gjuha dhe komunikimi artistik			
Tema mësimore: Tekstura si mjet shprehës ne dizajn			
Situata e te nxënit: Nxënësit zbulojne diferencen midis tekstures fizike dhe tekstures vizuale. Ata dallojne teksturen fizike ne natyre si psh, i lëmuar, e ashpër, e fortë etj. Zbulojnë karakteristikat e sipërfaqeve dhe teksturave vizuale të ndryshme të krijuara nga njeriu (psh. vizatimi i nyjeve te drurit ne leter eshte teksture vizuale) Vëzhgojnë mënyrën se si artistët kanë krijuar teksturën në veprat e tyre, në pikturë dhe dizajn.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">• Jep shembuj të sipërfaqeve të ndryshme në klasë dhe mjedisin rrethues.• Identifikon teksturën si element i rëndësishëm në veprat e artit.• Shprehet nëpërmjet përdorimit të teksturës në krijimin e tij/saj.• Krahason përdorimin e teksturës në pikturë dhe dizajn• Vlerëson rolin e teksturës ne artet pamore.		Fjalë Kyç: Tekturë fizike Tekturë vizuale	
Burimet: Art pamor 9		Lidhja me fushat e tjera:	
Metodologjia/ teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve:			
Hapi i parë: Parashikim me terma paraprakë			

Mësuesi/ja fton një nxënës përpara klasës dhe i lidh sytë. i vendos objektet e ndryshme në tavolinë dhe nxënësi i prek me radhë dhe i emërton. Mësuesi/ja pyet:

-Pra si i njohe ti këto sende?

-C ili element i rëndësishëm përcakton pamjen e jashtme të një sendi?

Nxënësit sit japin komentet e tyre.

Mësuesi/ja drejton bisedën në mënyrë që të dalë në pah roli i sipërfaqes së sendeve dhe trupave (tekstura fizike).

Çdo trup, send dhe gjallesë identifikohet nga sipërfaqja e jashtme e vet. Mësuesi/ja fton nxënësit që me teknikën e frotazhit të eksplorojnë lloje të ndryshme sipërfaqesh në klasë.

Hapi i dytë: Diskutim / Analizë rasti

Mësuesi/ja fton nxënësit në një fletë të imitojnë lloje të ndryshme sipërfaqesh. Pas kësaj mësuesi/ja i pyet për këto sipërfaqe duke drejtuar bisedën në mënyrë që nxënësit të nxjerrin në pah teksturen vizuale.

Tekstura në Dizajn, është kombinim i i elementeve te artit si pika linja, forma, tonaliteti etj, të cilat mund

të grumbullohen në mënyra të ndryshme. Në tabelë vendosen foto e te tekstures fizike dhe asaj vizuale te perdorura ne nje projekt grafik.

Hapi i tretë: Punë individuale

Mësuesi/ja fton nxënësit të eksperimentojne me teksturën fizike dhe vizuale ne klase.

Nxënësit punojnë të pavarur.

Vlerësimi: Vlerësohet nxënësi në të gjitha fazat e orës së mësimi, për aktivizimin, diskutimin në grup

ose individual dhe punën e pavarur.

Detyra: Nxënësit krijojnë sipas udhëzimeve ne libër dhe diskutojnë në klasë.

Planifikimi i orës mësimore

Fusha: Arte

Lënda: Art pamor

Shkalla: 4

Klasa: IX

Tematika: Gjuha dhe komunikimi artistik

Tema mësimore: Ekuilibri ose pasha pamore

Situata e te nxënit:

Nxënësit/et pyeten çfare kuptojne me ekuiliber. Nxenesit diskutojne rreth ekuilibrit ne fizikë dhe ekuilibrit pamor. Nxenesit/et analizojne menyrat e arritjes se ekuilibrit pamor permes ekuilibrit simetrik, asimetrik, dhe ekuilibrit radial. Ata ushtrohen ne menyren sesi ndikojne elementete artit ne peshen pamore, (psh figurat e medha jane me te renda se figurat e vogla, ngjyrat e ndezura jane me

te renda se ngjyrat e zbehta etj..)

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave:

Nxënësi/ja:

- Liston elementet e artit në një vepër
- Gjen skeletin kompozicional të veprës
- Argumenton simetrinë, asimetrinë në një vepër
- Kupton rolin e peshës vizuale dhe baraspeshës në një vepër
- Analizon menyren sesi elementet e artit ndikojne ne kompozim
- Vlerëson kompozimin si tërësinë e elementeve të veprës

Fjalë Kyç:

Kompozim
Ekuilibër
Ekuilibër simetrik
Ekuilibër asimetrik
Ekuilibër radial
Pesha pamore

Burimet: Art pamor 9

Lidhja me fushat e tjera:

Metodologjia/ teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve:

Hapi i parë: Parashikim me terma paraprakë

Mësuesi/ja vendos në tabelë disa imazhe dhe fton nxënësit të gjejnë elementet që njohin dhe të diskutojnë rreth tyre.

Pyet nxënësit:

- Çfarë elementesh vini re në këtë vepër?
 - Si i ka vendosur artisti figurat?
 - Nëse ju keni një hapësirë boshe të një dhome si do ta mobilonit?
 - A ju pëlqen mobilimi i shtëpisë tuaj?
 - Çfarë do të donit të ishte ndryshe, sipas shijes tuaj?
- Nxënësit japin komentet e tyre lidhur me pyetjet e bëra

Hapi i dytë: Diskutim / Analizë rasti

Mësuesi/ja pyet nxënësit:

- Cila është pikënisja e një vepre?
- Po ju, kur doni të krijoni çfarë pikë pyetjesh keni?
- Çfarë do të thotë kompozim për ju?

Më parë ju listuat disa nga elementet e përdorura në veprën e mësipërme. Një nga parimet e artit është edhe kompozimi. P.sh., nëse artisti do të hedhë idenë e tij në telajo atëherë gjëja e parë që bën mendon se si do ta kompozojë atë.

Kompozimi është bashkësia e elementeve të gjuhës pamore.

-Cilat janë këto elemente? Shenja, vija, vëllimi etj.

-si vendosen këto elemente?

Këto elemente vendosen të ndërthurura midis tyre në mënyrë që të kenë efekt dhe të komunikojnë një kuptim të caktuar.

Kompozimi simetrikë

Mësuesi/ja ilustron perms imazheve te tekstit apo material te tjera

Kompozimi asimetrikë

Mësuesi/ja ilustron perms imazheve te tekstit apo material te tjera

Kompozimi radialë

Mësuesi/ja ilustron perms imazheve te tekstit apo material te tjera

Pesha vizuale (ekuilibri).

Mësuesi/ja shpjegon qe per te arritur ekuilibrin artistet perdorin elementet e artit,

formen, ngjyren, pozicionin, teksturen, drejtimin, vleren tonale etj.

Hapi i tretë: Punë individuale

Mësuesi/ja fton nxënësit të eksperimentojnë me peshen pamore duke eksperimentuar përmes elementeve të artit

Formes, ngjyres, pozicionit, tekstures, drejtimin, vleres tonale etj.

Nxënësit punojnë të pavarur.

Vlerësimi: Vlerësohet nxënësi në të gjitha fazat e orës së mësimit, për aktivizimin, diskutimin në grup

ose individual dhe punën e pavarur.

Detyra: Nxënësit krijojnë ekuilibrin sipas udhëzimeve në libër dhe diskutojnë në klasë.

Planifikimi i orës mësimore			
Fusha: Arte	Lënda: Art pamor	Shkalla: 4	Klasa: IX
Tematika: Teknika dhe procese artistike:			
Tema mësimore: Teknikat grafike: lapustilat dhe përdorime të ndryshme			
Situata e të nxënësit:			
Nxënësit prezantohen me teknikën e lapustilave. Zbulojnë efektet dhe mundësitë shprehëse dhe i përdor në një krijim. Diskutojnë në klasë për të përbashkëtat dhe të veçantat e kësaj teknike krahasuar me teknika të tjera. Analizon dhe vlerëson piktura në teknikën e lapustilave. Nxënësit punojnë të pavarur .			
Rezultatet e të nxënësit sipas kompetencave:		Fjalë Kyç:	
Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none">• njihet me karakteristikat shprehëse të mjeteve;• përshtatet me mjetet artistike.• zbaton teknikat në krijimin e tij dhe kërkon rrugë të reja ndërthurjeje të teknikave.• fiton aftësi në përdorimin e teknikave nëpërmjet mënyrave shprehëse të tyre;• eksperimenton nëpërmjet ndërthurjes së teknikave të ndryshme		Lapustila mbulues lapustila me baze uji lapustila permanent grafikë, ilustrim	
Burimet: Art pamor 9		Lidhja me fushat e tjera:	

Metodologjia/ teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve:**Hapi i parë:** Parashikim me terma paraprakë

Mësuesi/ja paraqet përpara nxënësve disa nga mjetet kryesore që kanë lidhje me temën e ditës. Nëse nuk i disponon në klasë këto mjete atëherë mund të përdori edhe imazhe të pintuara ose të fotokopjuara.

Nxit nxënësit të flasin nëpërmjet pyetjeve:

-A i njihni këto materiale artistike?

-A keni punuar më parë?

Secili prej jush ka ngjyrosur me lapustila. – Nga se përbëhen?

Hapi i dytë: Diskutim / Analizë rasti

Lapustilat janë ngjyra tëplota dhe mbuluese. Ato janë njëteknikë e shpejtë dhe mjaft decorative ku mund të krijosh kontrast ngjyrash.

Lapustilat janë shumë të përdorur në fushën e grafikës dhe ilustrimit: në fakt janë mjete që garantojnë shenja

të forta dhe uniforme, që lejojnë krijimin e imazheve të ndritshme dhe me impakt të fortë.

Mësuesi/ja ilustron llojet e lapustilave dhe funksionin e tyre.

Hapi i tretë: Punë individuale

Mësuesi/ja fton nxënësit të eksperimentojnë duke ndjekur ushtrimet në liber.

Nxënësit punojnë të pavarur.

Vlerësimi: Vlerësohet nxënësi në të gjitha fazat e orës së mësimin, për aktivizimin, diskutimin në grup ose individual dhe punën e pavarur.

Detyra: Nxënësit pasi njihen me mundësitë shprehëse të kësaj teknike i sjellin në klasë dhe japin emocionet dhe preferencat për krijimet e bëra.

Planifikimi i orës mësimore			
Fusha: Arte	Lënda: Art pamor	Shkalla: 4	Klasa: IX
<p>Tematika: Teknika dhe procese artistike:</p> <p>Tema mësimore: Teknika stampimi dekorative, Xilografia, monotipi</p>			
<p>Situata e te nxënit:</p> <p>Nxënësit japin shembuj në klasë dhe në mjedisin rrethues të posterave, librave, banerave etj, që kanë lidhje me stampimin. Njihet me teknikat e ndryshme të stampimit. Nxënësit diskutojnë për përdorimin e stampimit në art dhe në jetën e përditshme. Vlerësojnë rolin e stampimit në jetën e përditshme dhe në art si dhe ku gjen përdorim në cilat fusha të jetës. Nxënësit/et nxiten të flasin mbi teknikat e stampimit që njohin dhe kanë përdorur. Ata/ato diskutojnë për karakteristikat e stampimit si një teknikë e shpejtë dhe që mund të përdoret mbi sipërfaqe të ndryshme.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave:</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Jep shembuj të stampimeve të ndryshme në mjedisin rrethues • Kupton pse artistët aplikuan stampimet nga materiale të ndryshme • Njihet me llojet e stampimeve artistike • Dallon ndryshimet midis teknikave • Krahason rezultatet sipas teknikave të stampimit • Vlerëson rolin e stampimit në jetën e përditshme 		<p>Fjalë Kyç:</p> <p>Stampim Xilografi Monotip</p>	
<p>Burimet: Art pamor 9</p>		<p>Lidhja me fushat e tjera:</p>	
<p>Metodologjia/ teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve:</p> <p>Hapi i parë: Parashikim me terma paraprakë Stampimi është një teknikë që bën të mundur krijimin e shumë kopjeve identike nga një origjinal i vetëm. Për të realizuar këtë teknikë duhet një shabllon i cili ngjyroset dhe shtypet mbi materialin e dëshiruar. Stampimi është teknikë e grafikës. Një histori e shkurtër mbi gdhendjen për të realizuar stampime të ndryshme.</p> <p>Hapi i dytë: Diskutim / Analizë rasti Mësuesi/ja pyet:</p>			

-Si mund të aplikosh imazhin mbi dru?

Ksilografia ose grafika në dru, është teknika më e vjetër e stampimit me relief.

Shablloni mbi të cilin realizohet gdhendja është prej druri të fortë. Bëhet vizatimi dhe me dalta të posaçme hiqen pjesët që

duam të mbeten të bardha. Më pas lyhen me rul dhe stampohen mbi letër.

Mësuesi/ja pyet?

-Sa stampime mund të bëjmë me këtë teknikë, një apo disa?

Historia e stampimit filloi në Kinë në shek. 14 me shpikjen e letrës dhe ksilografië, arti i gravurës në dru dhe stampimit nga një dru i gdhendur dhe më pas u përhap në Evropë.

Linoleum është një material industrial.

Butësinë e linoleumit e kanë shfrytëzuar artistët për ta gdhendur me lehtësi dhe më që më pas lyhet me anë të rullit dhe bëhet stampimi.

Monotipi është një teknikë stampimi që realizohet mbi një sipërfaqe xhami etj, që të jetë e lëmuar.

Si çdo teknikë dhe monotipi ka mjetet dhe mënyrën e vet të realizimit të imazhit.

Ndryshe nga teknikat e tjera që në fillim bëhej vizatimi dhe më pas bëhej lyerja me bojë nëpërmjet rullit, tek kjo teknikë më parë pikturohet sipërfaqja e xhamit me bojë vaji.

Vendosim një letër mbi xham dhe me një rul ushtrojmë presion mbi të dhe e heqim letrën me kujdes.

Monotipi mund të realizohet bardhezi ose me ngjyra por vetëm një herë.

Mësuesi/ja pyet nxënësit:

-Sa kopje mund të përftonim nga teknikat e tjera të stampimit?

-Ku qëndron ndryshimi me monotipin?

Hapi i tretë: Punë individuale

Mësuesi/ja fton nxënësit të realizojnë një nga teknikat e stampimit që është e përshtatshme për kushtet e klasës.

Mund të përdorin edhe mjete rrethore si gjethe, patate etj.

Mund të krijojnë edhe vulën e tyre ose një simboli duke përdorur goma, tapa, patate etj., nëse do gdhendin shkronja ato duhen vizatuar për së prapthi.

Nxënësit punojnë të pavarur.

Vlerësimi: Vlerësohet nxënësi në të gjitha fazat e orës së mësimi, për aktivizimin, diskutimin në grup

ose individual dhe punën e pavarur.

Detyra: Nxënësit eksperimentojnë teknika stampimi në kushtet e shtëpisë dhe diskutojnë për to në klasë. Mund edhe të krijojnë një poster me teknikën e preferua.

Planifikimi i orës mësimore			
Fusha: Arte	Lënda: Art pamor	Shkalla: 4	Klasa: IX
<p>Tematika: Historia, Arti dhe shoqëria:</p> <p>Tema mësimore: Zhvillimi I artit, Pasimpresionizmi</p>			
<p>Situata e te nxënit:</p> <p>Nxënësit diskutojnë rreth periudhave më të rëndësishme nëpër të cilat ka kaluar njerëzimi, nga pikëpamja historike.</p> <p>Nxjerrin në pah veçorinë e artit pasimpresionist. Nëpërmjet imazheve ata njihen me artistet kryesore të kësaj periudhe të artit dhe veçoritë e tyre. Krahasojnë veprat e artit të kësaj periudhe me periudha të tjera për të parë si ka evoluar arti.</p> <p>Kuptojnë rëndësinë e artit në zhvillimin e shoqërisë dhe si njerëzit u morën me art në periudha të ndryshme.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave:</p> <p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Identifikon pikësnyimet epas impresionistëve • Përshkruan teknikën e pikturës që ata zhvilluan për të arritur këto pikësnyime. • Diskuton disa nga veprat të krijuara nga artistët që shoqëruan këtë stil • Dallon piktorët pasimpresionistë dhe përshkruan disa nga punët e tyre. • Analizon influencat më të rëndësishme të artistëve pasimpresionistë • Dallon stilin e pasimpresionistëve. • Shpjegon influencën që patën pasimpresionistët në periudhat që pasuan. • Vlerëson rëndësinë e artit në zhvillimin e shoqërisë 		<p>Fjalë Kyç:</p> <p>Impresionizem Pasimpresionizem Drite dhe ngjyre Pol Sezan Pol Gogen Van Gog</p>	
<p>Burimet: Art pamor 9</p>		<p>Lidhja me fushat e tjera:</p>	
<p>Metodologjia/ teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve:</p> <p>Hapi i parë: Marrëdhënia pyetje- përgjigje. Mësuesi/ja nxit nxënësit të flasin nëpërmjet pyetjeve: -A mund të përmendni disa nga veprat më të njohura të periudhave që kemi kaluar deri tani? -Cilët janë artistët më të mëdhenj që njihni? -A ka ndryshim arti nga periudha në periudhë? -Çfarë ju thonë këta emra, Van Gog dhe Pol Sezan? -Cilës periudhë i përkasin? (Pasimpresionizmit) Mësuesi/ja shkruan në tabelë emrat e piktorëve më të mëdhenj pasimpresionistë:</p>			

Van Gog, Pol Sezan, Pol Gogen etj.
-Çfarë dini ju për këtë lëvizje artistike?

Hapi i dytë: Vezhgim / diskutim
Pasimpresionizmi.

-Çfarë dini ju për Van Gogun?

-Si duken pikturat e tij?

-E keni provuar ndonjëherë që të tregoni një histori nëpërmjet pikturës?

Artistët më të rëndësishëm të cilët kërkuar për zgjidhje të problemeve të impresionistëve ishin Pol Sezan,

Vinsent van Gog, Pol Gogen. Kërkimet e këtyre artistëve

për një përgjigje i udhëhoqën ata në drejtime të ndryshme dhe patën një efekt të rëndësishëm në kursin e historisë së artit. Secili prej këtyre artistëve donin të zbulonin se çfarë ishte gabim ose çfarë i mungonte impresionizmit. Ata nuk donin të fokusoheshin vetëm tek efektet e ndryshme të dritës mbi objekte.

Këta piktorë i përkisnin një grupi artistësh të cilët tani quhen pasimpresionistë.

Këta artistë u përfshijnë nga një interes i ri, për më shumë ngjyra të gjalla dhe një kthim te konturet e forta dhe format solide.

Pasimpresionizmi ishte një lëvizje franceze që menjëherë pasoi impresionizmin.

Artistët që u bënë pjesë e kësaj lëvizjeje treguan interes të madh për strukturën dhe formën ashtu siç bënë artistët impresionistë.

Hapi i tretë:

Mësuesi/ja fton nxënësit duke u frymëzuar nga pasimpresionizmi të krijojnë sipas dëshirës me teknikën e preferuar sipas shembujve të dhënë.

Vlerësimi: Vlerësohet nxënësi në të gjitha fazat e orës së mësimit, për aktivizimin, diskutimin në grup ose individual dhe punën e pavarur.

Detyra: Nxënësit gjejnë informacion më të detajuar për artin pasimpresionist dhe artistet kryesor të kësaj periudhe.
Mund të bëjnë dhe një prezantim në P.P.

Planifikimi i orës mësimore

Fusha: Arte

Lënda: Art pamor

Shkalla: 4

Klasa: IX

Tematika: Historia, Arti dhe shoqëria:

Tema mësimore: Fovizmi, Ekspresionizmi

Situata e te nxënit:

Nxënësit diskutojnë rreth periudhave më të rëndësishme nëpër të cilat ka kaluar njerëzimi, nga pikëpamja historike.
 Nxjerrin në pah veçoritë e ketyre periudhave. Nëpërmjet imazheve ata njihen me artistet kryesore të ketyre periudhave të artit dhe veçoritë e tyre. Krahasojnë veprat e artit të këtyre periudhave me periudha të tjera për të parë si ka evoluar arti.
 Kuptojnë rëndësinë e artit në zhvillimin e shoqërisë dhe si njerëzit u morën me art në periudha të ndryshme.

<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave: Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan stilin dhe synimet e artistëve fovistë • Identifikon dy artistë që shoqëruan këtë lëvizje • Përshkruan stilet e pikturimit të piktoreve pasimpresionistë. • Diskuton disa nga veprat të krijuara nga artistët që shoqëruan këtë stil • Diskuton synimet e ekspresionistëve dhe emërton disa nga artistët e kësaj lëvizjeje. • Analizon se si ndryshimet në shoqëri ndikuan edhe në art. • Vlerëson rëndësinë e artit në zhvillimin e shoqërisë 	<p>Fjalë Kyç:</p> <p>Fovizëm Ekspresionizëm</p>
---	---

<p>Burimet: Art pamor 9</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera:</p>
------------------------------------	----------------------------------

Metodologjia/ teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve:

Hapi i parë:
 Marrëdhënia pyetje- përgjigje.
 Mësuesi/ja nxit nxënësit të flasin nëpërmjet pyetjeve:
 -Çfarë dini ju për ndryshimet që pasuan në shek 20 në fusha të ndryshme të jetës?
 -Si u reflektuan këto ndryshime në art?
 -Mund të përmendni disa prej përfaqësuesve më të njohur të këtij shek në art, muzikë, letërsi?

Fillimet e shek 20 ishin një periudhë e revolucionit dhe ndryshimeve në art. Artistët prezantuan një Varietet stilesh të reja artistike që u shkëputën nga tradita e kaluar. Evropa u bë vendlindja e këtyre stileve të reja, por veprat e krijuara nga artistët amerikanë u bënë shembull frymëzimi për artistët në Evropë dhe në vende të tjera të botës.

Hapi i dytë: Vezhgim / diskutim
 Mësuesi/ja paraqet disa imazhe në tabelë. Pyet nxënësit:
 -A njihni ndonjë nga këta artistë?
 -Si duken veprat e tyre?
 -A ngjallin emocion?
 -Çfarë paraqesin, nga e kanë marrë temën?

Lëvizjet në artin europian.
 Ndërrimi i shekullit pa fundin e influencës akademike dhe fillimin e rrymave të reja të lëvizjeve artit të artit në Evropë. Një nga lëvizjet e para erdhi në vëmendjen e publikut në 1905. Një grup prej artistësh të rinj francezë nën udhëheqjen e Anri Matis ekspozuan veprat e tyre në Paris. Pikturat e tyre ishin aq të thjeshta në vizatim, aq të ndritshme në ngjyrë dhe aq të çlirëta në penelata, sa që një

kritik i inatosur i quajti artistët “ Fauves ” (të egër), ose “Wild beasts” (bisha të egra).

-Çfarë do të thotë termi “ ekspresionizëm”?

-Çfarë dini ju për këtë lëvizje artistike?

Në Gjermani stili artistik i fovistëve u pranua me padurim nga disa grupe artistësh. Artistët që ishin të interesuar në komunikimin e ndjenjave të thella emocionale nëpërmjet veprave të artit, u quajtën ekspresionistë .

Ekspresionizmi rezultoi në veprën që komunikonin ndjenja të forta emocionale.

Pak nga pak, artistët u shkëputën nga paraqitja e temave të tyre në mënyrë realiste.

Artistët përdorën ngjyra të errëta dhe forma për të përçuar ndjenjat e brendshme të subjekteve të tyre.

Hapi i tretë:

Analizë.

Mësuesi/ja fton nxënësit të vëzhgojnë një vepër të shek. 20 .

U dhëzon nxënësit të mbajnë shënimet sipas pikave që shkruan në tabelë duke dhënë pak të dhëna rreth saj.

- *Ndani fletën në katër kolona.*

1. Shkruani përshtypjen e parë që ju jep vepra.

2 . C ilat tipare të veprës janë më tërheqëse për ju.

3. C ilat tipare të veprës ju pëlqejnë më shumë.

4 . Dokumentoni cilësitë ku u mbështetët më shumë kur gjykuat këtë pikturë.

Vlerësimi: Vlerësohet nxënësi në të gjitha fazat e orës së mësimit, për aktivizimin, diskutimin në grup ose individual dhe punën e pavarur.

Detyra: Nxënësit gjejnë informacion më të detajuar për artin fovist dhe ekspresionist dhe artistet kryesor te kesaj periudhe.

Mund të bëjnë dhe një prezantim në P.P.

Planifikimi i orës mësimore

Fusha: Arte

Lënda: Art pamor

Shkalla: 4

Klasa: IX

Tematika: Historia, Arti dhe shoqëria:

Tema mësimore: Kubizmi, Futurizmi

Situata e te nxënit:

Nxënësit diskutojnë rreth periudhave më të rëndësishme nëpër të cilat ka kaluar njerëzimi, nga pikëpamja historike.
 Nxjerrin në pah veçoritë e ketyre periudhave. Nëpërmjet imazheve ata njihen me artistet kryesore të ketyre periudhave të artit dhe veçoritë e tyre. Krahasojnë veprat e artit të këtyre periudhave me periudha të tjera për të parë si ka evoluar arti.
 Kuptojnë rëndësinë e artit në zhvillimin e shoqërisë dhe si njerëzit u morën me art në periudha të ndryshme.

<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave: Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan stilin dhe synimet e artistëve kubistë dhe futuristë • Identifikon disa artistë që shoqëruan këto lëvizje • Përshkruan stilet e pikturimit të piktorëve të rrymave përkatëse. • Diskuton disa nga veprat të krijuara nga artistët që shoqëruan këtë stil • Shpjegon synimet e kubistëve dhe futuristëve dhe emërton disa nga artistët e kësaj lëvizjeje. • Analizon se si ndryshimet në shoqëri ndikuan edhe në art. • Vlerëson rëndësinë e artit në zhvillimin e shoqërisë 	<p>Fjalë Kyç:</p> <p>Kubizmi Futurizmi Manifest</p>
--	--

<p>Burimet: Art pamor 9</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera:</p>
------------------------------------	----------------------------------

Metodologjia/ teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve:

Hapi i parë:
 Marrëdhënia pyetje- përgjigje.
 Mësuesi/ja nxit nxënësit të flasin nëpërmjet pyetjeve rreth pikturës së Sezanit:
 -Si ju duket kjo pikturë e Sezanit?
 -Si i ka paraqitur natyrën?
 -Çfarë ju vjen në mendje kur themi kubizëm?
 -Çfarë dini ju për kubizmin?
 -A njihni ndonjë artist të kësaj rryme?
 -Si i paraqesin objektet artistët kubistë?
 Një tjetër lëvizje artistike e shek 20 që lidhet me veprat shumë në të njëjtën mënyrë me veprat e Pol Sezanit në shek, 19. Artistët si Pablo Pikaso dhe Zhorzh Brak filluan me idenë e Sezanit që të gjitha format në natyrë janë të bazuara tek koni, sfera dhe cilindri.

Hapi i dytë: Vezhgim / diskutim
 Mësuesi/ja paraqet disa imazhe në tabelë. Dhe nxit nxënësit të flasin rreth tyre.
 -Çfarë paraqesin këto piktura?
 -Cili ju pëlqen më shumë?
 -Çfarë ju sjellin ndërmend?

Kubizmi.
 -Çfarë do të thotë kubizëm?
 Kubizmi filloi kur artistët Pablo Pikaso dhe Xhorzh Brak u përpoqën të tregonin të gjitha anët e

objekteve

trepërmasore në një kanavace të sheshtë.

Kubizmi ishte një lëvizje pararojë e shek. 20, e përfaqësuar nga Pablo Pikaso dhe Georges Braque, që revolucionarizuan pikturën evropiane dhe skulpturën dhe frymëzuan lëvizje të ngjashme edhe në muzikë, letërsi dhe

arkitekturë. Në veprat kubiste objektet janë të thyera, analizuar dhe rimbledhur në një formë

abstrakte në vend që të pikturoheshin nga një pikë shikimi,

artistët pikturuan subjektin nga një mori pikash shikimi për ta paraqitur në një kontekst më të madh.

Kjo lëvizje kishte dhe manifestin e saj.

-Si janë ngjyrat në këtë pikturë të hershme tipike të pikturës kubiste?

Futurizmi.

-Çfarë kuptoni ju me fjalën “ Futurizëm”?

-Cilët ishin përfaqësuesit kryesorë?

-A u reflektuan këto lëvizje modern edhe në artet e tjera?

-Çfarë u zhvillua me shpejtësi në këtë periudhë?

-Nga se u ndikuan këta artistë?

Futurizmi ishte një lëvizje artistike dhe sociale që e pati origjinën në Itali në fillimet e shek. 20.

Ai e vuri theksin tek shpejtësia, teknologjia, rinia dhe vulgariteti, si dhe tek objekte të tilla si makinat, aeroplanët dhe qytetet industriale.

Si frymëzim të saj kishte shpejtësinë, teknologjinë dhe

modernizmin, të portretizuara në jetën me karakter dinamik të shek 20.

Futuristët kishin dhe manifestin e tyre.

Disa artiste te kesaj levizje jane: Bocconi, Balla, Carra, Severini dhe Marineti.

Hapi i tretë:

Mësuesi/ja fton nxënësit duke u frymëzuar nga kubizmi dhe futurizmi të krijojnë sipas dëshirës me teknikën e preferuar sipas shembujve të dhënë.

Vlerësimi: Vlerësohet nxënësi në të gjitha fazat e orës së mësimit, për aktivizimin, diskutimin në grup

ose individual dhe punën e pavarur.

Detyra: Nxënësit gjejnë informacion më të detajuar për artin Kubist dhe Futurist, artistet kryesor te kesaj periudhe.

Mund të bëjnë dhe një prezantim në P.P.